

SHOQERIA "ALFA" SH.A VRISERA - GJIROKASTER

PROJEKTI I BASHKIMIT

Ne mbeshtetje te nenit 58 te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" te nenit 243, 244, 245 dhe 248 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e ortakeve te shoqerise, "Alfa" Sh.a. dhe "Alfa-Glina" sh.p.k. ka diskutuar operacionin e bashkimit te ketyre shoqerive ne nje shoqeri te vetme duke caktuar drejtorin e pergjithshem te shoqerise "Alfa" sh.a. z.Kristo Nacin te hartoje projektin e bashkimit.

Lenda e projektit:

- 1- Te dhena mbi shoqerite pjesemarrese ne operacionin e bashkimit.
- 2- Qellimi dhe kushtet e bashkimit.
- 3- Caktimin dhe vleresimin e aktivitetit dhe te pasivitetit qe eshte parashikuar t'i kaloje shoqerise perthithese ("Alfa" sh.a.)
- 4- Menyrat e dorezimit te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Alfa-Glina" sh.p.k. tek shoqeria "Alfa" sh.a., si dhe daten pas se ciles operacionet e shoqerise se perthithur ("Alfa-Glina" sh.p.k.) do te konsiderohen, ne aspektin e kontabilitetit si te kryera nga shoqeria "Alfa" sh.a.
- 5- Datat kur jane hartuar llogarit e shoqerive pjesemarrese.
- 6- Raportin e kembimit te drejtave ne shoqeri.
- 7- Primi I bashkimit.

I - Te dhena mbi shoqerite:

Shoqerite qe marrin pjese ne operacionin e bashkimit jane:

- a- "Alfa" sh.a.
- b- "Alfa-Glina" sh.p.k.

Shoqeria "Alfa" sh.a. si person juridik eshte krijuar si rezultat i Vendimit Nr.1141 akti, te dates 21.10.1992 te Gjykates se rrethit Gjirokaster. Si shoqeri tregtare ne formen e shoqerise anonime me oferte publike shoqeria eshte krijuar me Vendimin nr. 7686, date 29.10.1993 te gjykatës së rrethit Tiranë me emërtimin "Alfa" SH.a. me oferte publike e përbërë nga kater ortake z.Vasil Naci,

z.Kosta Sotiri, z.Kristo Naci, z.Jorgo Zoidhis.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërise është 2.000.000 lekë i ndare ne aksione me vlere nominale secila prej 20.000 leke.

Selia e shoqërise është ne Vrisera Gjirokaster.

Me Vendimin nr. 7686/3, datë 29.09.2003 të gjykatës së rrethit Tiranë është bere shtese kapitali prej 347.440.000 leke, pra kapitali themeltar i shoqërise është bere prej 349.440.000 leke ai zoterohet nga:

1- ortaku Vasil Naci zoteron 25 % te kapitalit, ose 4.368 aksione me vlefte prej 87.360.000(tetedhjeteshtatemiljonetregjashtedhjetmije)leke,

2 - ortaku Kosta Sotiri zoteron 25 % te kapitalit, ose 4.368 aksione me vlefte prej 87.360.000(tetedhjeteshtatemiljonetregjashtedhjetmije)leke,

3 - ortaku Kristo Naci zoteron 25 % te kapitalit, ose 4.368 aksione me vlefte prej 87.360.000(tetedhjeteshtatemiljonetregjashtedhjetmije)leke,

4 - ortaku Jorgo Zoidhis zoteron 25 % te kapitalit, ose 4.368 aksione me vlefte prej 87.360.000(tetedhjeteshtatemiljonetregjashtedhjetmije)leke.

Shoqëria "Alfa-Glina"shp.k. si person juridik është krijuar si rezultat i Vendimit Nr.12964, te date 01.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane. Me vendimet perkatese te asamblese se kesaj shoqërie jane bere disa ndryshime si tek ortaket me anen e shitjese se pjeseve te tyre te kapitalit ashtu dhe te disa neneve te Statutit duke u depozituar keto vendime ne regjistrin tregtar prane gjykates se rrethit Tirane. Keshtu vendimet e asamblese jane depozituar nepermjet vendimeve te Gjykates se rrethit Tirane me Nr.12964/3 per zevendesimin e ortakut A.A.Marketing me shoqërine "Alfa"sh.a me daten 02.12.1996, me vendimin Nr.12964/4 date 30.12.1996 per ndryshimin e administratorit ku ne vend te Maksi Bales u zgjodh administrator Gligor Xhumba dhe disa ndryshime ne Statutin e shoqërise, me vendimin Nr.12964/5 date 09.01.1997 per shitjen e pjeses se kapitalit te ortakut Krenar Muco shoqërise "Alfa"sh.a. dhe ndryshimet perkatese ne Statut te perqindjes se pjesetareve nepermjet shitblerjes se pjeseve te kapitalit, me Vendimin Nr.12964/9 (6761),date 30.06.1999 te Gjykates se rrethit Tirane Shoqëria "Alfa"sh.a. zoteron te gjithe kapitalin (100 %) te regjistruar te shoqërise "Alfa-Glina"sh.p.k.prej 723.372.966,40 leke .
Selia e shoqërise është ne Gline Gjirokaster.

II - Qellimi dhe kushtet e bashkimit

Duke patur parasysh se shoqeria "Alfa" sh.a është ortakë e vetme, ose pjesëmarrëse e vetme në kapitalin themeltar të shoqërisë "Alfa-Glina" sh.p.k. drejtimi i shoqërisë "Alfa" sh.a ka si qëllim përqendrimin e kapitalit në një shoqëri të vetme.

Një arsye tjetër është se nga shoqeria "Alfa-Glina" sh.p.k. janë realizuar ransaksione shitblerje dhe shërbimesh për llogaritë të shoqërisë "Alfa" sh.a e cila ka bërë që të bëhen regjistrime të dyfishta në librat kontabelë dhe në pasqyrat financiare që ndikojnë në mos përpunimin në kohë të rezultateve. Pra është menduar përqendrimi i këtyre veprimeve në qendër të shoqërisë "Alfa" sh.a. ku kontrolli dhe përpunimi i tyre realizohet në një afat më të shkurtër.

Qëllimi i drejtimit të shoqërisë thithese është të bëhet një përqendrim i investimeve me një teknologji bashkëkohore dhe hartimin e një plani strategjik lidhur me vijueshmërinë e aktivitetit dhe të fondit tregtar (emri i mirë) në treg të shoqërisë. Kushtet e bashkimit janë duke shpërbërë shoqërinë "Alfa-Glina" sh.p.k. dhe duke transferuar tërësinë e aktiveve dhe borxheve të saj shoqërisë thithese "Alfa" sh.a. Ky operacion do të realizohet pasi të hartohen llogaritë e se cilës shoqëri me bilanc të vecanta dhe pastaj të bashkohen në një bilanc të vetëm (bilanc i konsoliduar).

III - Caktimin dhe vlerësimin e aktivitetit dhe pasivitetit që është parashikuar t'i kalojë shoqërisë përthithese "Alfa" sh.a.

Për caktimin dhe vlerësimin e aktivitetit dhe pasivitetit që është parashikuar të përthithet shoqëria "Alfa" sh.a. do të hartohen llogaritë e konsoliduara të cilat do të vërtetohen nga ekspertët kontabelë të autorizuar, si dhe do të miratohen nga asambleja e rëtakeve e këtyre dy shoqërive. Në këtë vërtetim do të merret parasysh vlera kontabelë e hyrjes së asetëve dhe borxheve në pronësi të shoqërisë thithese.

Kjo vlerë do të jetë vlera e kembimit global të shoqërisë së thithur "Alfa-Glina" sh.p.k. në momentin e shpërberjes së kësaj shoqërie. Marrja e vlerës kontabelë është me e thjeshtë, si dhe në siguron homogjenitetin e vlerësimeve: vlerat kontabelë të shoqërisë së thithur u shtohen vlerave kontabelë të shoqërive thithese, absorbuesë, të mirat e sjella gjenden në bilancin pas shkrirjes, të vlerësuarë sikur të ishin marrë që nga origjina nga shoqëria thithese.

IV - Menyrat e dorëzimit të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "Alfa-Glina" sh.p.k. tek shoqëria "Alfa" sh.a, si dhe datën pas së cilës operacionet e shoqërisë së përthithur "Alfa-Glina" sh.p.k. do të konsiderohen, në aspektin e kontabilitetit si të kryera nga shoqëria "Alfa" sh.a.

Shoqeria e thithur "Alfa-Glina" sh.p.k. shperbehet dhe transferon teresine e aktiveve dhe borxheve te saj shoqerise thithese "Alfa" sh.a.

Shoqeria "Alfa" sh.a. do te rezultoje me nje zmadhim te kapitalit duke emetuar aksione te reja te cilat i jepen ortakut te shoqerise se thithur i cili behet keshtu ortak e shoqerise thithese, ne rastin tone jane te njejtet ortak.

Emetimi i aksioneve te reja do te behet pa ndryshuar perqindjet e pjesemarrjes se ortakëve ne kapitalin themeltar te shoqerise, dhe konkretisht:

1-z.Vasil Naci me pjesemarrje 25 % te kapitalit

2-z.Kosta Sotiri me pjesemarrje 25 % te kapitalit,

3-z.Kristo Naci me pjesemarrje 25 % te kapitalit,

4-z.Jorgo Zoidhis me pjesemarrje 25% te kapitalit.

Data pas se ciles operacioni i shperberjes se shoqerise "Alfa-Glina" sh.p.k.ne aspektin e kontabilitetit do te konsiderohet 31.10.2003, dhe veprimet ne kontabilitet pas kesaj date do te kryhen nga shoqeria perthithese "Alfa" sh.a. nga data 01.11.2003 e ne vazhdim.

V - Datat kur jane hartuar llogarite e shoqerive pjesemarrrese.

Nga drejtimi i shoqerive pjesemarrrese ne operacionin e bashkimit jane parashikuar datat e hartimit te llogarive.

Llogarite qe do te bashkohen I referohen dates 31.10.2003.

VI - Raporti i kembimit te drejtave ne shoqeri.

Raporti i kembimit te aksioneve te emetuara do te behet duke siguruar paanesi ne kembimin e tyre, pasi shoqeria "Alfa" sh.a. eshte zoteruesja e vetme e pjeseve te kapitalit te shoqerise qe shperbehet.

VII -Primi i bashkimit.

Emetimi i aksioneve (titujve) nga shoqeria thithese do te sjell nje rritje te kapitalit te barabarte me numrin e aksioneve te emetuara x vleren nominale te aksioneve te cilat do te percaktohen pas perfundimit te operacionit te bashkimit te llogarive te dates 31.10.2003.

Ky project bashkimi do te perfundoje me hartimin e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, me miratimin e ketij raporti ne asamblene e ortakëve te shoqerive pjesemarrrese, me miratimin e ndryshimeve ne statutin e shoqerise thithese.

Per hartimin e raportit te, ose vertetimin e bilancit te konsoliduar (bashkuar)
drejtimi i shoqerise ka vendosur z. Elton Haxhi si eksperte kontabel me Licence
Nr.95 date 11.01.2001.

Pergaditja e gjithe dokumentacionit te operacionit perfundimtar te bashkimit te
shoqerise "Alfa" sh.a. me shoqerine "Alfa-Glina"sh.p.k. do te realizohet sipas
kerkesave te Ligjit "Mbi Shoqerite Tregtare " dhe statutit te shoqerise.

Gjirokaster, me 05 Nentor 2003

Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise

"Alfa" Sh.A.

Kristo NACI

Kristo Naci

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Kristo Naci', is written over a vertical line that extends from the company name above. The signature is somewhat stylized and overlaps the line.